

ANEKSI NR.1



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË**

**“SHËRBIME TË INTEGRUARA SIGURIE PËR GODINAT, NË INSTITUCIONET E
ARSIMIT PARASHKOLLOR E SHKOLLOR DHE INSTITUCIONET E TJERA TË
BASHKISË TIRANË”**

**TERMA REFERENCE KËRKESAT
FUNKSIONALE DHE TEKNIKE**

TIRANË 2023

1. HYRJE

1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues

Bashkia Tiranë

1.2. Historiku

Arsimi parauniversitar është një ndër tre sektorët që zë më shumë peshë në buxhetin e Bashkisë së Tiranës. Në vijim të zbatimit me sukses të politikave dhe objektivave strategjike të Bashkisë Tiranë në fushën e arsimit parauniversitar, veç investimeve në çerdhe, kopshte dhe shkolla, Bashkia e Tiranës vlerëson të domosdoshëm planifikimin dhe implementimin e projekteve dhe shërbimeve, që kanë synim rritjen e sigurisë, si dhe reduktimin e rrezikut nga aktivitete të paligjshme, dëmtimet apo rastet e emergjencës për të gjithë fëmijët në këto institucione.

2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

2.1 Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: “Shërbime të integruara sigurie për godinat, në institucionet e arsimit parashkollor e shkollor dhe institucionet e tjera të Bashkisë Tiranë”. Menaxhimi i survejimit të Sistemeve të kamerave, alarmit kundra vjedhjeve, kundra Zjarrit, për shkelje perimetrale etj. (24 orë në ditë)

2.2 Kohëzgjatja: 3 (tre) vjet

2.3. Objektiv/ Qëllimi i projektit: Mbulimi me një sistem të integruar sigurie që do të mundësojë instalimin e kamerave CCTV, menaxhimin e ruajtjes së pamjeve filmike të monitorimit nepermjet paisjeve elektronike rregjistuese të kamerave CCTV, instalimin menaxhimi i sistemit të alarmit kundër vjedhjes dhe kundra zjarrit si dhe nderhyrja me verifikues të sistemeve të alarmit (grup i gatshëm), në institucionet publike ku ushtrojnë funksionet strukturat e Bashkisë Tiranë, si dhe në institucionet e arsimit parashkollor e shkollor si një nga objektivat strategjike të programit të qeverisë për sigurinë në sistemin arsimor.

2.4 Përshkrim i përgjithshëm i projektit

Sistem sigurie në sistemin arsimor: Arsimi parauniversitar është një ndër tre sektorët që zë më shumë peshë në buxhetin e Bashkisë së Tiranës. Veç investimeve në çerdhe, kopshte dhe shkolla, bashkia synon edhe implementin e një sistemi të integruar të shërbimeve nëpërmjet monitorimit me kamera të sigurisë dhe sisteme alarmi me qëllim rritjen e sigurisë në këto institucione.

Përveçse një aset në shkolla, implementimi i këtij sistemi është një detyrim i vazhdueshëm që vjen si pasojë e kërkesës nga institucionet përkatëse dhe organet kompetente për rendin dhe sigurinë publike në vend në funksion të mësimdhënies dhe mundëson qëllimin final, që janë ambientet të sigurtat e të mbrojtura për fëmijët/ nxënësit e mësuesit.

Për një mbulim me shërbim të integruar sigurie për të gjitha institucionet e sistemit arsimor të territorit të Bashkisë Tiranë, janë planifikuar në këtë projekt institucionet arsimore të zonave urbane dhe interurbane.

Sistem sigurie në institucionet ku ushtrojnë funksionet strukturat e Bashkisë Tiranë:

Duke mbajtur në konsideratë një tërësi shërbimesh ndaj qytetarëve që ofrohen nga Bashkia Tiranë, si dhe referuar kërkesave të vazhdueshme lidhur me pajisjen me sistem sigurie për godinat ku ushtrojnë funksionet strukturat e Bashkisë Tiranë, është planifikuar në këtë projekt përfshirja dhe mbulimi me sisteme sigurie për godinat ku ushtrojnë veprimtarinë institucione/ njësi organizative në varësi të Bashkisë së Tiranës.

2.5 Rezultatet e pritshme

Nëpërmjet këtij projekti do të realizohet:

- Krijimin e sistemit të integruar (sisteme alarmi, reagim me grupe të gatshme, kamera sigurie);
- Detektimin dhe zbulimin në kohë reale të aktiviteteve të paligjshme, zjarreve, si dhe ndërhyrjen e menjëhershme të grupeve të gatshme;
- Rregjistrimet e marra nga monitorimi 24 orë në 365 ditë të vitit për parandalimin në kohë reale të aktiviteteve të paligjshme;
- Shkëmbim informacioni në kohë reale me strukturat e tjera përgjegjëse për monitorimin dhe ndjekjen e autorëve të veprimeve të kundra ligjshme;
- Integrimi i funksionaliteteve për gjeoreferencimin e pajisjeve rregjistruese të cilat mundësojnë rregjistrimin automatik si dhe të koordinatave gjeografike të vendodhjes së ngjarjes;
- Ruajtja e të dhënave/ provave në databazën e serverit kur konstatohen shkelje dhe referimi i tyre në institucionet përkatëse (polici, gjykata, prokurori etj).

Siguria e sistemit të integruar:

Ruajtje e sigurtë e të dhënave. Të dhënat në sistemet duhet të jenë 100% të sigurta dhe duhet të jetë e pamundur të fshihet ndonjë e dhënë.

Sistemi i integruar i shërbimeve është një hap i rëndësishëm në monitorimin dhe rritjen e parametrave të sigurisë dhe padyshim një kontribut i mirë që i jepet përmirësimit të rendit, sigurisë dhe normave të sjelljes e etikës qytetare dhe asaj profesionale në institucionet publike, arsimore apo sociale të Bashkisë Tiranë.

3. PËRFITIMET E PROJEKTIT:

- Objektivi kryesor i përzgjedhjes së këtij shërbimi është krijimi i një sistemi të integruar sigurie në institucione të sistemit parashkollor dhe shkollor, si dhe disa institucione të tjera të Bashkisë Tiranë.

Nëpërmjet këtij shërbimi bëhet i mundur realizimi i:

- 1) Krijimi i sistemit të integruar të sigurisë me sisteme alarmi, reagim nëpërmjet grupit të gatshëm.
- 2) Detektimi dhe zbulimi në kohë reale të aktiviteteve të paligjshme, zjarreve si dhe ndërhyrjen e menjëhershme të Grupeve të gatshme.
- 3) Rregjistrimet e Monitorimit 24/7 gjatë gjithë vitit për parandalimin në kohë reale të ngjarjeve dhe situatave të paligjshme.
- 4) Ruajtja e të dhënave/ provave në databazën e serverit kur konstatohen shkelje sipas përcaktimeve ligjore të Ligjit Nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”.
Udhezim Nr. 633, datë 6.11.2018 Per Percaktimin e nivelit te masave te sigurise dhe llojin e masave qe duhet te marrin subjektet ne varesi te aktivitetit apo te vleresimit te rrezikut, si dhe procedurat e njoftimit te tyre.

- Nëpërmjet implementimit të shërbimeve të integruara synojmë të rrisim sigurinë, si dhe të reduktojmë rrezikun nga aktivitete të paligjshme, dëmtimet apo rastet e emergjencës në institucione.

Ky sistem do të funksionojë në kohë rekord dhe do të mundësojë:

- Akses total në sistem, koordinim me institucionet përkatase, si dhe bashkëpunim më i ngushtë midis institucioneve dhe shërbimeve të sigurisë.
- Kontroll mbi sistemin e sigurisë dhe ndërhyrje e grupeve të gatshme në çdo lloj situatë.
- Rregjistrimet e Monitorimit dhe gadishmëri 24 orë në 365 ditë të vitit i sistemit të sigurisë për ndërhyrje të menjëhershme për çdo situatë që mund të krijohet.

- Parandalim i krimeve: Kontrolli 24/7 mundëson vëzhgimin deri në asimilimin e rasteve të rrezikshme;
- Reagim i menjëhershëm: evidentim dhe ndërhyrje e menjëhershme pasi nëpërmjet sistemit çdo department reagon;
- Eficiençë në menaxhim: Organizim i saktë i gjithë procedurave standarte nga lajmërimi deri tek zgjidhja e situatës në vendngjarje;
- Zgjidhje ekonomike: reduktim i kostove, ofrim shërbimi në terma afatgjatë nëpërmjet një sistemi të unifikuar shërbimesh sigurie, duke përfshirë projektim-implementim-mirëmbajtje;
- Rritja e përgjegjshmërisë: ky sistem jo vetëm siguron por edhe kontrollon bashkëveprimin mësues-nxënës, punonjës-qtetarë, duke rritur përgjegjshmërinë ndaj detyrave;
- Parandalim i dëmeve fizike: kombinimi perfekt i teknologjisë me forcën njerëzore minimizon humbjet dhe dëmtimet në objekte, nëpërmjet kamerave, sensorëve dhe sinjalizuesve.

Nëpërmjet implementimit të një sistemi të sofistikuar sigurie, përfitojmë përmirësim të niveleve të sigurisë për të identifikuar e parandaluar rreziqet, ofrimin e një shërbimi të vazhdueshëm, përfundim të standarteve të shërbimit, rritjen e efikasitetit operacional dhe reduktimin të kostove. Institucionet e ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike kanë një referencë më shumë për rregjistrimin e pamjeve filmike të perfituara nga ky projekt dhe kjo është një masë që do të sjell jo vetëm përmirësimin e sigurisë si mase parandaluese në këto objekte ku do të montohen sistemet e integruara të sigurisë, instalimi i sistemeve të integruara të sigurisë ku ushtrojnë veprimtarinë struktura të Bashkisë

Tiranë ndikon drejtperdrejte ne rritjen e sigurise ne keto objekte dhe ne parandalimin e ngjarjeve me karakter penal por në veçanti përmirësimin e sigurisë të arsimit parashkollor dhe shkollor, duke i shërbyer akoma më shumë cilësisë së mësimdhënies, sigurisë së ambientit, sigurisë së fëmijëve dhe natyrisht sigurisë mendore të prindërve të tyre.

4. MODALITETE TË FUNKSIONIMIT TË PROJEKTIT

Projekti është parashikuar të zhvillohet nëpërmjet procedurës së prokurimit "Marrëveshje Kuadër", e cila ka për qëllim të sigurojë shërbim të vazhdueshëm nëpërmjet sistemit të integruar të sigurisë në këto institucione. Gjithashtu, për efekt të përlogaritjes së vlerës së marrëveshjes kuadër, i referohet, për aq sa është e mundur, nevojave të planifikuara për këtë objekt, përlogaritja e të cilave në çdo rast duhet të jetë sa më e plotë dhe gjithëpërfshirëse, me qëllim shmangien e situatave kur dalin nevoja të reja, për të njëjtin objekt, të papërfshira në marrëveshjen kuadër.

Për këtë qëllim është planifikuar përfshirja në këtë projekt: të godinave/ institucioneve të sistemit arsimor në zonat urbane dhe ato interurbane të qytetit të Tiranës, institucioneve ku ushtrojnë veprimtarinë struktura të Bashkisë Tiranë apo njësi të tjera organizative në varësi të cilat janë funksionale nga pikëpamja e aktivitetit institucional, përfshirë godinat të cilat janë në proces rikonstruksioni apo investime të reja, si dhe godina të cilat janë mbyllur përkohësisht për shkak të gjendjes infrastrukture dhe funksionale në të cilën ndodhen (situata aktuale), si dhe godina/ institucione/ njësi shërbimi të reja të cilat parashikohet të planifikohen në projektet e investimeve gjatë viteve në vijim (situata të pritshme).

4.1 Supozimet e projektit

1. Implementimi i projektit është parashikuar të realizohet Brenda 60- ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës së shërbimit me Kontraktuesin. Kjo periudhë është parashikuar duke marrë në konsideratë shtrirjen e objekteve sipas vendndodhjeve në të gjithë territorin/ Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë.
2. Projekti do të përfundojë me sukses brenda afateve të përcaktuar në dokumentacionin për këtë procedurë.
3. Autoriteti Kontraktor duhet të plotësojë kushtet dhe standartet për funksionimin normal të sistemit të sigurisë.
4. Autoriteti kontraktor do të vërë në dispozicion të operatorit ekonomik të gjitha informacionet lidhur me situatën aktuale dhe atë të pritshme, infrastrukturën ekzistuese, dokumentet, rregulloret dhe materialet e nevojshme për të mundësuar implementimin e sistemit nga ana e kontraktorit që do të ofrojë këtë shërbim.
5. Informacioni i shkëmbyer mes palëve duhet të mbetet konfidencial.
6. Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.
7. Staf i operatorit ekonomik duhet të jetë i aftë të punojë në një ambient me disiplinë të ndryshme pune.
8. Stafet përkatës të autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik duhet të jenë komunikues dhe të aftë të bashkëpunojnë.

4.2 Detyrat specifike për realizimin e e projektit dhe plan dorëzimi.

I gjithë projekti duhet të ndërtohet duke u bazuar në fazat si më poshtë:

I. Plan paraprak i detajuar për ekzekutimi i implementimit

Operatori ekonomik në bashkëpunim me stafin e Bashkisë Tiranë, duhet të realizojë:

- Bashkia e Tiranës në cilësinë e Autoritetit Kontraktor nëpërmjet strukturave të saj përpara lidhjes së kontratës së shërbimit i vë në dispozicion Kontraktuesit situatën aktuale të numrit të godinave/ njësive të shërbimit që janë funksionale ose jofunksionale sipas vendndodhjeve konkrete;
- Survejim në ambjentet publike ekzistuese dhe atyre të reja për të realizuar një plan të detajuar e konkret të realizimit të implementimit;
- Prodhimin e dokumentacionit teknik mbi ambjentet publike ku do të realizohet implementimi, instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve si dhe infrastrukturës së nevojshme, duke propozuar dhe plan vendosjen në cdo ambjent, mbulimin që ofron secila nga pajisjet dhe specifika të tjera teknike në funksion të implementimit, si dhe afatet kohore të parashikuara për dorëzim;
- Kontraktuesi në bashkëpunim me stafin e Bashkisë Tiranë, do të përgatisë rregulloren e përbashkët për funksionimin e shërbimit në çdo objekt, dokumentacionin teknik të nevojshëm ku do të përcaktohet me saktësi skema e ngritjes dhe funksionimit të sistemit të monitorimit përfshirë reagimin në rast nevoje me grupe të gatshme të specializuara etj., referuar tipologjisë së përgjithshme të përshkruar në kërkesat funksionale dhe teknike;
- Kontraktuesi duhet të realizojë një plan të detajuar ekzekutimi të implementimit dhe plan dorëzim shërbimi. Gjatë procesit të implementimit të sistemit, vendosjes së pajisjeve, struktura të Bashkisë Tiranë do të asistojnë procesin, verifikojnë realizimin e implementimit të sistemeve të sigurisë dhe marrin në dorëzim shërbimin nëpërmjet raporteve/ relacioneve/ procesverbaleve të konstatimit për çdo objekt.

Modeli i mësipërm do të ndiqet në mënyrë që të arrihet një rezultat i kënaqshëm i implementimit të projektit si nga ana e performancës, efencës ashtu edhe nga ana e sigurisë.

II. Instalim dhe Implementim i pajisjeve të infrastrukturës

Gjatë kësaj faze duhet të realizohen:

- Vendosja e pajisjeve në vendndodhjet ku do të realizohet shërbimi (referuar vendndodhjeve/ hapësirave publike) i pajisjeve e komponentëve të kërkuar pjesë e këtij projekti.
- Instalimi e konfigurimi i pajisjeve sipas të dhënave që do i vërë në dispozicion AK, në vendndodhjet e dakordësuara gjatë Fazës I.
- Implementimi i projektit/ sistemit, i cili është parashikuar të realizohet Brenda 60- ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës së shërbimit me Kontraktuesin. Kjo periudhë është parashikuar duke marrë në konsideratë shtrirjen e objekteve sipas vendndodhjeve në të gjithë territorin/ Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë.
- Dokumentimi procesit nëpërmjet raporteve/ relacioneve/ procesverbaleve të konstatimit për çdo objekt, pas verifikimit nga struktura të Bashkisë Tiranë.

Nëqoftëse gjatë Fazës II për implementim të pajisjeve të infrastrukturës, do lindë nevoja për ndryshime të vendndodhjeve të dakordësuara gjatë fazës I, OE do të marrë përsipër realizimin e tyre, pasi të dakordësohet nga palët.

Procedurat e marrjes në dorëzim të shërbimit, faturimit etj janë procedura që do të detajohen me nënshkrimin e kontratës.

III. Raportimi:

Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme:

- **Raporti Fillestar** do të fillojë të hartohet, nga nënshkrimi i kontratës/ fillimi i implementimit, pas vënies në dispozicion nga AK të informacioneve të nevojshme. Nga data e përfundimit nga Kontraktuesi të implementimit të sistemit/ konfigurimeve përkatëse/ vënies në funksion të sistemit dhe përdorimin e saj nga AK, Kontraktuesi dhe AK (strukturat përkatëse) do të nënshkruajnë proces verbalin e marrjes në dorëzim.
- Raporti do të përpilohet nga Kontraktuesi dhe duhet të përmbajë ecurinë e implementimit, specifikat e procesit, detajet e përdorimit të përdoruesit etj., ose/ dhe duhet të përmbajë një analizë të situatës aktuale, si dhe një plan pune të detajuar së bashku me afatet kohore për implementimin e sistemit, mënyrën, skemën e ngritjes së rrjetit të monitorimit përfshirë reagimin në rast nevoje me grupe të gatshme të specializuara etj.
- **Drafti i raportit përfundimtar.** Ky raport duhet të dorëzohet jo më vonë se 5 ditë para përfundimit të periudhës së zbatimit të detyrave.
- **Raporti final** duhet të përfshijë komentet e pranuar nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit përfundimtar është 5 ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Raporti duhet të përmbajë ecurinë e implementimit, specifikat e procesit, detajet e përdorimit të përdoruesit etj. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet së bashku me faturën përkatëse.
- **Raportimi periodik:** Nga data e vënies në funksion të sistemit dhe përdorimin e tij, Kontraktuesi duhet të paraqesë raportin periodik të shërbimit të ofruar. Kontraktuesi i dorëzon AK (strukturës përkatëse) që të nënshkruajë proces verbalin e kryerjes së shërbimit. Periudha e këtij raportimi do të jetë cdo muaj.

5. VENDNDODHJA DHE SHPËRNDARJA E SHËRBIMIT QË DO TË MBULOHET:

5.1 Në të gjitha institucionet e sistemit arsimor dhe institucionet ku ushtrojnë veprimtarinë struktura të Bashkisë Tiranë, brenda territorit të qytetit të Tiranës.

5.2 Shpërndarja

Në këtë projekt është planifikuar përfshirja dhe mbulimi me sisteme sigurie për institucione të sistemit arsimor në zonat urbane dhe ato interurbane të qytetit të Tiranës, institucione ku ushtrojnë veprimtarinë struktura të Bashkisë Tiranë apo njësi të tjera organizative në varësi, të cilat janë funksionale nga pikëpamja e aktivitetit institucional, përfshirë godinat të cilat janë në proces rikonstruksioni apo investime të reja godina të cilat janë mbyllur përkohësisht për shkak të gjendjes infrastrukurore dhe funksionale në të cilën ndodhen, (situata aktuale), si dhe godina/ institucione/ njësi shërbimi të reja të cilat parashikohet të planifikohen në projektet e investimeve gjatë viteve në vijim (situata të pritshme).

Numri i përgjithshëm i godinave/ institucioneve/ njësive organizative të përfshira/planifikuara në këtë projekt për të cilat kërkohet ofrimi i shërbimit të sigurisë, parashikohet në total 418 njësi shërbimi e shpërndarë sipas pikave/vendndodhjeve të mëposhtme:

1. Sistem sigurie në sistemin arsimor:

1.1 Në zonat urbane të qytetit të Tiranës 166 institucione arsimore (NJ. Administrative Nr.1; NJ. Administrative Nr.2; NJ. Administrative Nr.3; NJ. Administrative Nr.4; NJ. Administrative Nr.5; NJ. Administrative Nr.6; NJ. Administrative Nr.7; NJ. Administrative Nr.8; NJ. Administrative Nr. 9; NJ. Administrative Nr.10; NJ. Administrative Nr.11);

1.2. Në zonat interurbane të qytetit të Tiranës 123 institucione arsimore (NJ. Administrative Petrelë; NJ. Administrative Farkë; NJ. Administrative Dajt; NJ. Administrative Zall-Bastar; NJ. Administrative Bërzhitë; NJ. Administrative Krrabë; NJ. Administrative Baldushk; NJ. Administrative Shëngjergj; NJ. Administrative Vaqarr; NJ. Administrative Kashar; NJ. Administrative Pezë; NJ. Administrative Ndroq; NJ. Administrative Zall-Herr);

2. Sistem sigurie në institucione/ njësi organizative në varësi të Bashkisë së Tiranës:

2.1. Në godinat ku ushtrojnë veprimtarinë institucionale drejtori/ departamente/ njësi organizative të Bashkisë Tiranës 70 njësi shërbimi;

2.2 Në godinat ku ushtrojnë veprimtarinë Institucione të tjera sociale të Bashkisë Tiranë: Drejtoria e Banesave Sociale 3 njësi shërbimi; Menca Sociale 5 njësi shërbimi; Qendra Sociale 6 njësi shërbimi.

3. Përgjatë kohëzgjatjes së kontratës/ Marrëveshjes Kuadër, mund të nevojiten lidhje të reja për të cilat do të fillojë ofrimi i shërbimit sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor:

3.1 Situata të pritshme: 45 godina/ institucione/ njësi shërbimi

Për të gjitha pikat/vendndodhjet do të ketë mundësi rialokimi sipas kërkesave të Bashkisë Tiranë.

5.3 Shërbimi dhe grafiku i ekzekutimit

Afati për efekt të implementimit të sistemeve të sigurisë (objekti i kësaj kontrate) në të gjitha objektet sipas vendndodhjeve nuk duhet të kalojë 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e lidhjes së kontratës/ kontratave.

Afati i fillimit të ekzekutimit të shërbimit do të fillojë të llogaritet nga data e vënies në funksion të sistemit dhe përdorimin e tij nga AK, për të gjitha objektet sipas vendndodhjes.

Afati i realizimit të shërbimit do të jetë për një periudhë kohore 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj ose (tre) vjet, nga momenti i implementimit të sistemeve të sigurisë.

Sipas nevojës AK do të kërkojë shërbim në godinat sipas njësive të shërbimit ku përfshihen 3 komponentët e sistemit të sigurisë (monitorim me kamera dhe sistem alarmi dhe sistem zjarri) dhe sipas rastit do kërkojë shërbim në ato godina/ njësi shërbimi ku do të jetë e nevojshme vetëm dy apo më pak komponentë të sigurisë (monitorim me kamera dhe/ose sistem alarmi dhe/ose sistem zjarri) .

Faturimi i shërbimit për çdo vendndodhje (*Situata aktuale, Situata e Pritshme*) do të realizohet për sa kohë vendndodhja do të ketë shërbim aktiv, pra do të jetë funksionale. Në rast se ndonjë nga vendndodhjet nuk do të duhet të jetë më funksionale (në ofrimin e shërbimit) me kërkesë të Autoritetit Kontraktor, vendndodhja respektive nuk do të vijojë të faturohet nga operatori ekonomik. Në rast të ndryshimit të vendndodhjes, Operatori ekonomik do të ofrojë këtë shërbim në vendndodhjen e re.

Nëqoftëse operatori ekonomik do të kryejë detyrat e implementimit përpara periudhave të parashikuara, respektivisht do të avancohen afatet për fazat pasardhëse (Afati i fillimit të ekzekutimit të shërbimit).

6. KËRKESA SPECIFIKE DHE KRITERE TË VEÇANTA

6.1. Staf i dhe Eksperienca

Subjekti i kontraktuar duhet të disponojë:

- Licencë për ushtrimin e aktivitetit të ruajtjes dhe sigurimit fizik të objekteve publike dhe private në kategorinë "1.3.A" konform Ligjit Nr.75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike",
- Qendër kontrolli në Qarkun Tiranë me Akt Miratim të lëshuar nga DVP Tiranë,
- nuk duhet të ketë masa administrative për shoqërinë, për titullar subjekti, për drejtuesin teknik, gjatë ushtrimit të aktivitetit për vitin 2022 (konform ligjit nr.75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike", Udhëzim Ministri i Brendshëm Nr 130 date 05.03.2018. "Për funksionimin e Shërbimit privat të sigurisë fizike";
- Vërtetim Performance lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë për vitin 2022, kategoria 1.3.A, konform ligjit nr.75/2014 dhe akteve nënligjore në fuqi për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike përmes të cilit të provohet që operatori ekonomik disponon Jo me pak se 26 punonjës shërbimi.

6.2 Staf kryesor i kontraktorit duhet të ketë në përbërje minimalisht punonjës/ specialistë të kualifikuar në fushat respektive për realizimin e këtij shërbimi, të profileve si më poshtë:

- Punonjës shërbimi
- Specialist për sisteme të sigurisë, për sisteme alarmi
- Operator salla kontrolli
- Punonjës për verifikimin e sinjaleve të alarmit;
- teknik paisjesh transmetuese dhe specialist të rrjetit kompjuterik;
- Ekspert zjarrfikës të certifikuar;
- Inxhinier të profileve: Inxhinier Kompjuterik, Inxhinier elektronik ose informatik, Inxhinier Telekomunikacioni, inxhinier mekanik, inxhinier ndertimi, inxhinier të pajisur me licensë profesionale;
- Punonjës TIK (Teknologji Informacioni dhe Komunikimi);
- Punonjës të certifikuar ITIL Foundation Certificate in IT Service Management, punonjës të certifikuar në Menaxhimin e Projekteve Profesionale, punonjës të certifikuar për VMS, Lead Auditor;
- Punonjës të certifikuar nga kompania prodhuese e sistemit të alarmeve dhe sistemit të kamerave

Eksperiencia e punës dhe profilet e specialistëve të stafit kryesorë do të duhet të vërtetohen nga ana e kontraktorit me kopje të diplomave/ dëshmime/ certifikatave përkatëse.

1.2 Certifikime për:

- Sistemin e menaxhimit të siguri së informacionit;
- Menaxhimin e siguri së dhe shëndetit në punë;
- Menaxhimin e mjedisit;
- Menaxhimin e cilësisë

7. KËRKESA FUNKSIONALE DHE TEKNIKE

Montimi i paisjeve të sigurisë

Operatori ekonomik do marrë përsipër montimin e të gjitha paisjeve të sigurisë:

DVR, Kamera dhe Sisteme Alarmi dhe zjarri, kanalina, kablo apo tuba. Montimi i paisjeve do të bëhet për ruajtjen e perimetrit dhe hapësirave të jashtme të objektit. Gjithashtu montimi i kamerave do të bëhet në ambientet hyrese të objekteve dhe në koridoret ku ka levizje njerëzish. Paisjet qendrore si DVR do të vendosen në dhomat e serverit apo në zyrën e secilit drejtues institucioni përkatës.

Cdo koridor apo hapësirë e rëndësishme e objektit do të jetë e survejuar me kamera CCTV që mundësojnë rregjistrimin e pamjeve filmike 24/7 dhe të monitoruar me sistem alarmi dhe sistem zjarri në përjdhën kur sistemi është i aktivizuar.

Instalimi do bëhet në mënyrë të specializuar nga një staf i certifikuar.

Konfigurimi i paisjeve të sigurisë

Paisjet e kamerave dhe DVR do të konfigurohen në mënyrën më të përshtatshme për të qenë sa më efektive.

Testimi dhe trajnimi i paisjeve të sigurisë

Në përfundim të instalimit në çdo objekt do të bëhet testimi i sistemeve.

a. Transmetimi i çdo sinjali të sistemit të zjarrit apo alarmit në Qendrën e kontrollit

b. Rregjistrimi i pamjeve filmike të kamerave në zyrën e personit përgjegjës apo smartphoni të personit përgjegjës ku është vendosur pajisja elektronike rregjistruese e pamjeve filmike.

c. Trajnimi i përdoruesve të sistemeve të sigurisë.

d. Kontaktet dhe kushtet e përdorimit në rast se ka problematika

Kërkesat e sallës operative

Operatori ekonomik do të sigurojë AK që në perfundim të fazës së instalimit do të ketë në kontroll nga salla operative të gjithë objektet me të dhëna si nr kontakti për çdo objekt, ndarjen e zonave sipas çdo sistemi alarmi apo objekti.

Mirembajta e sistemit të sigurisë

Operatori ekonomik do të marrë përsipër zgjidhjen e difekteve të sistemit të kamerave brenda 24 orëve nga marrja e njoftimit.

Operatori ekonomik do të marrë përsipër zgjidhjen e difekteve të sistemit të alarmit dhe të zjarrit brenda 8 orëve nga marrja e njoftimit.

Sherbim Survejimi

Sherbimi do të jetë (24 orë në ditë) për gjatë gjithë periudhës së sherbimit dhe përfshin:

- Gadishmerine e Verifikuesve të sinjalit të alarmit (Grupit të Gatshëm) sipas zonave, vendqendrimeve të Verifikuesve të sinjalit të alarmit (Grupeve të Gatshme), rrugëkalimi i grupeve të gatshme, reagimi i grupeve të gatshme nga marrja e njoftimit nga Qendra e Kontrollit e dhe paraqitja në objekt të jetë jo më shumë se minutazhi: (5 min-8min).
- Rregullore për objektet ku do të kryhet sherbimi dhe plan emergjence për parandalimin e problematikave që mund të shfaqen gjatë sherbimit.
- Punonjësit e Verifikimit të alarmeve të licensuar me lejet përkatëse të lëshuara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut ku prokurohet në bazë të Ligjit për SHPSF 75/ 10.07.2014 dhe Udhezimit nr. 130, datë 05.03.2018 “Për funksionimin e sherbimit privat të sigurisë fizike”. Të gjithë punonjësit e Verifikimit të Alarmit duhet të jenë të pajisur me mjetete nevojshme për realizimin e sherbimit komform ligjit për SHPSF dhe udhezimit përkatës. Punonjësit e Verifikimit të Alarmit duhet të jenë të specializuar dhe të trajnuar me Certifikatat dhe për kryerjen e sherbimit sipas Legjislacionit në fuqi për SHPSF dhe Udhezimit 130/05.03.2018. Punonjësit e Verifikimit të Alarmeve duhet të kenë trajnimet përkatëse në bazë të ligjit për SHPSF dhe udhezimit 130 /05.03.2018 “Për funksionimin e sherbimit privat të sigurisë fizike”, si dhe të jenë instruktuar/trajnuar teknikisht “për Mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin” për të mundësuar evakuimin e nxënësve dhe fëmijëve në rastet e Zjarreve të mundshme. Përgjatë ditës, në zonat sipas ndarjes, punonjësit e Verifikimit të Alarmit preferohen të jenë me mjete lëvizëse motorr për shkak të trafikut të ngarkuar që kanë zonat e Kryeqytetit. Sherbimi i Verifikimit të alarmit duhet të jetë i akorduar me Sallen Operative të SHPSF, nga Punonjes Sherbimi të Certifikuar në bazë të ligjit 75/2014 dhe Udhezimit 130/05.03.2018, si dhe Ixhinieret e nevojshëm për Informatik ose Elektronik dhe Teknik IT për zgjidhjen sa më të shpejtë të problematikave të mundshme.
- Paisjet në Sallen Operative të Qendres së kontrollit të SHPSF-së, të kenë servera të tilla me kapacitete të mjaftueshme për perballimin e volumit të kontratës për të gjithë objektet që do të kryhet sherbimi, ofrimin e sherbimit për Radiokomunikimin dhe Radiolarmi në gjithë Qarkun e

Tiranes, paisjet e domosdoshme per Qendren e Kontrollit si Server, Repetitor, Radio Stacionare per komunikimin e menjehershem me Punonjesit e Verifikimit te Sistemeve te Alarmeve.

- Numrat telefonik të rajoneve të policisë, zjarrëfikseve dhe të personave kryesorë përgjegjës të objektit.

- Skemën e njoftimit në rast sulmi ose zjarri në objekt.

Raportimi

Raporti duhet të përmbajë:

- kohën e ndodhjes së ngjarjes
- objekti ku është zhvilluar ngjarja
- një përshkrim të shkurtër të ngjarjes
- kohën e verifikimit
- emrin e personit që bën verifikimin

Specifikimi i Materialeve:

Per kryerjen e sherbimit eshte e nevojshme paisja me materialet e domosdoshme per verifikimin, nderhyrjen dhe zgjidhjen e problematikave si me poshte:

Automjete, Motora

Salle Operative

Sisteme Survejimi dhe Alarme dhe Kamerave

Sistem Kundra Zjarrit

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve:

- Te siguroje objektet duke vendosur sistemin e sigurise

- Rregjistimi i pamjeve filmike te pajisjeve si dhe te sistemeve te Alarmit 24 ore ne dite, 7 dite ne jave per gjithe periudhen e kontrates. Sherbimi do te perfshije marrjen e sinjalit te alarmit ne Sallen se Kontrollit me aktivizime alarmi te plota dhe aktivizime alarmi paniku. Operatoret e Salles se Kontrollit njoftojne menjehere verifikuesit qe te shkojne ne objektin nga vjen sinjali i alarmit.

- Veprimet e Grupit të Gatshëm në vendngjarje me marrjen e njoftimit nga Salla e Kontrollit te SHPSF: do të jenë në mbrojtje të jetës së personave duke neutralizuar, bllokuar, ndjekur e ndaluar, elementin criminal; do të veprojnë në rastet e Zjarreve te mundeshme per të parandaluar dhe minimizuar sa me shume demet qe mund te shkaktohen per objektet qe do te monitorohen kur keto sisteme jane te aktivizuara; njoftojne menjehere Policine e Shtetit sipas vlerësimit te rastit, etj. Veprimet e Grupit te Verifikimit te Sinjaleve te alarmit do te kryhen ne perputhje te Rregulloreve dhe Ligjit per SHPSF 75/2014 dhe Udhezimeve shoqerues 130/05.03.2018; Veprimet operative dhe përdorimi i armëve luftarake do të kryhen në përputhje me Ligjin

nr.75/2014, “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, Ligjin nr.74, datë 10.07.2014, “Për përdorimin e armëve luftarake”.

Koha e ndërhyrjes dhe e veprimit të Grupit të Gatshëm në vendngjarje të jetë nga minimum 5’(pese minuta) deri maksimumi 8 (tete minuta).

Pajisjet qendrore te sistemit – Digital Video Recorder profesional, software i administrimit të sistemit, ruajtjes së administrimit të imazheve

Pajisja qendrore e regjistrimit dhe administrimit të imazheve dhe vetë sistemit, do të jetë një pajisje “e gjitha në një” e cila inkorporon:

- Softwarin e nevojshëm për administrim të imazheve
 - Softwarin e nevojshëm për administrimin e vetë sistemit dhe të kamerave
 - Hardwarin e nevojshëm për rregjistrimin e imazheve

Kapaciteti minimal me të cilin duhet të rregjistorjne pajisjet është - 10 dite sipas pikes 2.10 te Udhëzimit Nr. 633, datë 6.11.2018 Per Percaktimin e nivelit te masave te sigurise dhe llojin e masave qe duhet te marrin subjektet ne varesi te aktivitetit apo te vleresimit te rrezikut, si dhe procedurat e njoftimit te tyre.

Specifikimet teknike minimale të domosdoshme:

Zgjidhja e propozuar duhet, minimalisht, të plotësojë kërkesat dhe funksionet e mëposhtme:

- Regjistrim në cilësi të lartë **H.265+**, **MPEG-4**, **M-JPEG** dhe **MxPEG**.
- Regjistrim në megapixel-të paktën deri **15 fps** në format **1080P** në të gjithë kanalet njëherësh.
- Konfigurimi: Nga **web**.
- Monitorim në distance: Nga **web**.
- Karakteristika të plota regjistrimi: regjistrim manual, i vazhduar ose i skeduluar.
- Aftësi planifikimi për regjistrimin e alarmeve.
- Aftësi monitorimi për disa sisteme survejimi në **LAN** ose **WAN** nëpërmjet një motori.
- Hapësirë në memorie për imazhet e gjeneruara nga regjistrimet e alarmeve, hapësirë për regjistrim para dhe pas këtyre regjistrimeve të paktën deri në **300 sekonda**.
- Regjistrim video për kamerat.
- Aftësi për backup të të dhënave në një pajisje tjetër në rrjet.
- Aftësi për t’i vendosur pamjeve një shenjues digital si p.sh. **watermark** për të konfirmuar vërtetësinë e tyre.

Gjatë monitorimit lokal sistemi duhet të jape mundësinë e kontrollit të regjistrimeve (të paktën nëpërmjet datës dhe orës së regjistrimeve), si edhe kontroll të regjistrimeve:

- Luaj (play)
- Pushim
- Ndalim
- Para/mbrapa
- Ndryshimi i shpejtësisë së shfaqjes së regjistrimeve me shpejtësi normale dhe të shpejtë deri në **1 x16** dhe shpejtësi të reduktuar deri në **1/16**.

Për kontrollin e regjistrimeve sistemi duhet të bëjë playback për të paktën **12 kanale** në të njëjtën kohë, të mund të bëjë kontrole në regjistrime nëpërmjet datës/orës, te kamerave në rrjet të cilat kanë dalë nga fokusi). Duhet të bëjë menaxhimin e regjistrimeve:

- Luaj (play)
- Pushim
- Ndalim
- Para/mbrapa
- Ndryshimi i shpejtësisë së shfaqjes së regjistrimeve me shpejtësi normale dhe të shpejtë deri në **1 x16** dhe shpejtësi të reduktuar deri në **1/16**.

- Sistemi duhet të bëjë kërkim dhe analizë të videos në mënyrë inteligjente sipas: Datës dhe orës, sipas vijës së kohës, sipas ngjarjeve.

- Analiza inteligjente e videos që duhet të jetë e përfshirë në sistemin bazë duhet të ketë aftësitë që të dallojë kamerat që nuk janë të fokusuara, të dallojë kamerat që ju bllokohet pamja, të ketë mundësinë e fokusimit në objekte të vecanta.

- Konvertimi në format të përshtatshëm për **PC** i videos dhe shkarkimi nga serveri i regjistrimit.

Menaxhimi i ngjarjeve

Sistemi duhet të ofrojë mundësinë e konfigurimit të ngjarjeve si:

- Dedektimi i lëvizjeve.
- Alarm input.
- Probleme në lidhjen fizike (*network*.)
- Probleme në regjistrim.

Për këto ngjarje përdoruesit duhet të njoftohen nëpërmjet:

- Gjenerimit të videove dhe njoftimeve për to.
- Nëpërmjet e-mail, drejtuar përdoruesve të përcaktuar.
- Buzzer (*njoftim akustik*).
- Alarm output
- Nëpërmjet mesazheve tekst.

Kontrolli i përdoruesve

Sistemi duhet t'i ofrojë administratorit:

- Mundësinë e krijimit të përdoruesve të ndryshëm, me të drejta të ndryshme aksesi.
- Kontrollin e përdoruesve që kanë të drejta aksesi, ose jo, në sistem.
- Aftësinë për të gjeneruar një listë me përdoruesit që janë online në sistem.

Sistem Alarmi

Menyrat e transmetimit

- GPRS
- SMS
- CLIP

Është gjithashtu e mundur të dërgojë mesazh SMS në stacionin e monitorimit vetëm në rast të mungesës së shërbimit GPRS ose të marrjes së IP-së të korrumpuar (të programuar në të njëjtën kohë të dy opsionet "Send Event @ GPRS" dhe "Send Event @@ SMS1").

Pavarësisht nga komunikimi me serverin e Qendrës së Sigurisë, transmetuesi mund të dërgojë informacionin e zgjedhur (alarmet) tek shefi i sigurisë se postes të mbrojtur (SMS2) që përmban përshkrim të qartë të situatës.

Gjithashtu në rast se mesazhi CLIP, transmetuesi mund të dërgojë një mesazh me tekst për Specialistin e sigurisë të objektit (njëkohësisht të programuar të dyja opsionet "Send Event @ CLIP" dhe "Send Event @@ SMS1").

Nëse transmetuesi nuk mund të krijojë lidhjen me adresën kryesore të serverit ("Server IP1") për të dërguar atje një mesazh, atëherë përpiqet ta bëjë atë në adresën e serverit rezervë ("Server IP2"). Nëse është ende e pamundur, transmetuesi dërgon një mesazh mbi formularin e SMS (vetëm nëse është caktuar një opsion "Dërgo mesazh @ GPPRS"). Nëse Qendra e Sigurisë nuk ka IP server rezervë atëherë të dyja adresat duhet të programohen të njëjta. IP adresat ndoshta programohen si shifra (si 19x.155.12.1: 7551) ose si emrat DNS

Te ekzistojnë disa metoda se si të marrin mesazhet nga transmetuesit por në çdo rast pjesa kryesore e sistemit të marrjes është një softuer me funksionalitet të TCP / IP Server dhe adresa IP konstante duhet të sigurohet.

- metoda më e thjeshtë te jete përdorimi i softuerit të automatizuar të pajisur

1. DVR 4 KANALE

Hyrja Audio	1-kanal
Kompresimi Video	H.265/H.264
Hyrjet Video	4-kanale analoge, Nderfaqja e lidhjes BNC
Tipet e kamerave qe suporton	4 MP, 3 MP, 1080p AHD: 4 MP, 1080p, 720p CVI:1080p, 720p
Kompresimi Audio	G.711u, PCM
Nderfaqja e Hyrjes Audio	1-kanal, RCA
Daljet HDMI/VGA	1920 × 1080 ,1280 × 1024, 1280 × 720
Rezolucioni Regjistrimit	4 MP /3 MP/1080p/ 720p/WD1/4CIF/VGA/CIF
Bit Rate Videos	32 Kbps-6 Mbps
Dalja Audio	1-kanal, RCA
Bit Rate Audios	64kbps
Dual Stream	Suporton dy Stream(Main dhe Sub)
Playbacku Sinkron	4-kanale
Protokollet e rrjetit	TCP/IP, PPPoE,DNS, DDNS, NTP, UPnP, HTTPS,ONVIF
Nderfaqja Hard Diskut	1-nderfaqe SATA , Deri ne 10 TB
Nderfaqee rrjetit	1-porte RJ-45, 10/ 100Mbps
Nderfaqe USB	2-porta USB (USB 2.0)

2. DVR 8 KANALE

Hyrja Audio	1-kanal
Kompresimi Video	H.265/H.264
Hyrjet Video	8-kanale analoge, Nderfaqja e lidhjes BNC
Tipet e kamerave qe suporton	4 MP, 3 MP, 1080p AHD: 4 MP, 1080p, 720p CVI:1080p, 720p
Kompresimi Audio	G.711u, PCM
Nderfaqja e Hyrjes Audio	1-kanal, RCA
Daljet HDMI/VGA	1920 × 1080 ,1280 × 1024, 1280 × 720
Rezolucioni Regjistrimit	4 MP /3 MP/1080p/ 720p/WD1/4CIF/VGA/CIF
Bit Rate Videos	32 Kbps-6 Mbps
Dalja Audio	1-kanal, RCA
Bit Rate Audios	64kbps
Dual Stream	Suporton dy Stream(Main dhe Sub)
Playbacku Sinkron	8-kanale
Protokollet e rrjetit	TCP/IP, PPPoE,DNS, DDNS, NTP, UPnP,

	HTTPS,ONVIF
Nderfaqja Hard Diskut	1-nderfaqe SATA , Deri ne 10 TB
Nderfaqee rrjetit	1-porte RJ-45, 10/ 100Mbps
Nderfaqe USB	2-porta USB (USB 2.0)

3. DVR 16 KANALE

Hyrja Audio	1-kanal
Kompresimi Video	H.265/H.264
Hyrjet Video	16-kanale analoge, Nderfaqja e lidhjes BNC
Tipet e kamerave qe suporton	4 MP, 3 MP, 1080p AHD: 4 MP, 1080p, 720p CVI:1080p, 720p
Kompresimi Audio	G.711u, PCM
Nderfaqja e Hyrjes Audio	1-kanal, RCA
Daljet HDMI/VGA	1920 × 1080 ,1280 × 1024, 1280 × 720
Rezolucioni Regjistrimit	4 MP /3 MP/1080p/ 720p/WD1/4CIF/VGA/CIF
Bit Rate Videos	32 Kbps-6 Mbps
Dalja Audio	1-kanal, RCA
Bit Rate Audios	64kbps
Dual Stream	Suporton dy Stream(Main dhe Sub)
Playbacku Sinkron	16-kanale
Protokollet e rrjetit	TCP/IP, PPPoE,DNS, DDNS, NTP, UPnP, HTTPS,ONVIF
Nderfaqja Hard Diskut	1-nderfaqe SATA , Deri ne 10 TB
Nderfaqee rrjetit	1-porte RJ-45, 10/ 100Mbps
Nderfaqe USB	2-porta USB (USB 2.0)

4. DVR 32 KANALE

Hyrja Audio	1-kanal
Kompresimi Video	H.265/H.264
Hyrjet Video	32-kanale analoge, Nderfaqja e lidhjes BNC
Tipet e kamerave qe suporton	4 MP, 3 MP, 1080p AHD: 4 MP, 1080p, 720p CVI:1080p, 720p
Kompresimi Audio	G.711u, PCM
Nderfaqja e Hyrjes Audio	1-kanal, RCA
Daljet HDMI/VGA	1920 × 1080 ,1280 × 1024, 1280 × 720
Rezolucioni Regjistrimit	4 MP /3 MP/1080p/ 720p/WD1/4CIF/VGA/CIF
Bit Rate Videos	32 Kbps-6 Mbps
Dalja Audio	1-kanal, RCA
Bit Rate Audios	64kbps
Dual Stream	Suporton dy Stream(Main dhe Sub)
Playbacku Sinkron	16-kanale
Protokollet e rrjetit	TCP/IP, PPPoE,DNS, DDNS, NTP, UPnP, HTTPS,ONVIF
Nderfaqja Hard Diskut	1-nderfaqe SATA , Deri ne 10 TB

Nderfaqe rrjetit	1-porte RJ-45, 10/ 100Mbps
Nderfaqe USB	2-porta USB (USB 2.0)

5. KAMERA TE BRENDSHME

Cilesia e imaxhit	2MP CMOS
Lloji sinjalit	PAL/NTSC
Rezolucioni	1920(H) × 1080(V)
Lentja	2.8mm, 3.6mm
Infrat	Deri ne 10 m
Dalja HD	Dalje analoge
Kushtet e punes	-40 °C + 60 °C
Ushqimi i kameres	12 VDC±15%

6. KAMERA TE JASHTME

Cilesia e imazhit	2MP CMOS
Lloji i sinjalit	PAL/NTSC
Rezolucioni	1920(H)*1080(V)
Lentja	2.8mm, 3.6mm
Dalja HD	Dalje Analoge
Kushtet e punes	-40 °C + 60 °C
Ushqimi i kamres	12 VDC±15%
Kushtet e jashtme	IP66
Infrat	Deri ne 40 metra

7. HDD 3 TB

Kapaciteti	3 TB
Nderfaqja	SATA
Madhesia	3.5 inch
Dimensionet (L x W x H)	5.79" x 4" x 1.03"

8. HDD 4 TB

Kapaciteti	4 TB
Nderfaqja	SATA
Madhesia	3.5 inch
Dimensionet (L x W x H)	5.79" x 4" x 1.03"

9. HDD 6 TB

Kapaciteti	6 TB
Nderfaqja	SATA
Madhesia	3.5 inch
Dimensionet (L x W x H)	5.79" x 4" x 1.03"

10. USHQYES 12V 10 A

Tensioni i hyrjes	220VAC -15%
Frekuenca e punes	50Hz/60Hz
Tensioni daljes	12VDC/10A
Fuqia	120W

11. USHQYES 12V 5 A

Tensioni i hyrjes	220VAC -15%
Frekuenca e punes	50Hz/60Hz
Tensioni daljes	12VDC/5A
Fuqia	60W

12. MONITOR 22"

Teknologji me ndriçim LED, rezolucion	1920 × 1080
Dimensioni i monitorit	22 inch
Nderfaqja hyrese	2 kanale, DVI/VGA
Ndricimi	245cd/m2
Kontrasti	1000:1

13. PLATFORME MENAXHIMI ALARMI (SERVER)

CPU	Intel Core i5 @ 2.9 GHz
RAM	8GB
NIC	Karte Rrjeti te dedikuar
Karte Grafike	NVIDIA GeForce GTX 660 ose me e mire
Tipi i HDD	SATA II Hard Drive 80GB ose me mire
Kapaciteti HDD	240GB per Sistemin Operativ dhe Programin e Monitorimit
Sistemi Operativ	Microsoft Windows 7/8/10 dhe MSSQL Express 2005 ose me I ri

14. KABINET METALIK

Te jete i pershtatshem per me shume se 3 prodhues nderkombetare sistemesh alarmi.

Pesha te mos jete me e madhe se 2.2 Kg

Hapesira e baterise te jete per nje bateri 12V7A

Ushqimi ne hyrje te jete 230V/AC.

Ushqimi ne dalje te jete Dalja 1=16V/AC ose u2 18V/AC

Te kete mbrojtje ndaj Antikorozionit

15. TRANSMETUES GPRS

Transmetuesi te jete i pajisur me 8 hyrje alarmi dhe tre dalje të programueshme, të kontrolluara në distancë. Te kete nje hyrje te 9 rezerve per te ardhmen.

Paisja të jetë në përputhje të plotë me standartet ndërkombetare dhe protokollet e komunikimit Ademco, Contact ID dhe SIA dhe të ketë mundësinë që në të ardhmen të integrohet me panele kontrolli të tjera.

Ky panel i alarmit të brendshëm te kete te integruar dhe sistemin e zjarit

16. MODUL MARRES 4 KANAL

Të jetë me 4 kanale për identifikimin e çdo kanali kur merr sinjale
Të ketë mundësi për marrje sinjali ON/OFF të sistemit (Aktivizim/Çaktivizim).
Të ketë mundësi fikje automatike me një kohe të programuar nga 1s deri në 4 Orë.
Kodimi i sistemit të ketë një teknologji KEELOQ ose ekuivalente me të.
Frekuenca e operimit të paisjes të jetë midis 430 mhz - 870 mhz.
Buton Paniku per sisteme alarmi me kontakte NO dhe NC

17. BATER 12V 7 Ah

Bateria e ofruar te jete e pershtatshme te vendoset ne kabinetin metalik te ofertuar
Bateria te jete e pershtatshme per Kabinetin metalik.
Bateria te jete 12V 7A

18. SENSOR LEVIZJE

Distanca e mbulimit të sensorit të jetë jo më e vogël se 15 metra.
Sensori të jetë i selektueshem EOL resistor.
Të ofrojë mundësinë e detektimit ndaj insketeve apo levizjeve të ajrit.
Plastika ABS.
Te jetë në përputhje me standartet EN 50131-1 ose ekuivalent me te
Sensori të ketë të inkorporuar rezistorët me vlera 6K 8,5K 6,4K 7K dhe 1K dhe vlera per tamperin 5K 6, 4k 7 2k 2k dhe 1 K ne perputhje me të gjithë panelet e kontrollit në botë ose ekuivalente.

19. SENSOR ZJARRI

Te kete teknologjine dual me ngjyra LED
Te ofroje mundesiete n/C dhe n/o
Te jete Brenda standarteve EN 54-5 / 7:2000 standard
Te detektoje ne 100m2 per tymin dhe ne 50m2 per nxehtesine
Pesha maximale jo me shume se 140gr
Temperatura e punes -10- +50 grade

20. PULT KOMANDIMI 2CH

Te kete teknologjine Keeloq
Frekuenca e operimit te jete nga 430 MHZ deri ne 440 MHZ
Distanca mesatare e transmetimit te jete me e larte se 80 metra
Te kete te perfshire baterine 12 V
Te operoje ne temperature -20 grade deri ne40 grade

21. SIRENE E JASHTME

Sirena të jete e jashtme dhe e përshtatshme me sistemet
Sirena të ketë minimalisht 115 Db zhurmë
Dalja e audios të jetë 115+-3 DB
Të punojë në 10-12 VDC
Njoftues alarmi me ndriçim LED

22. KABËLL RG59+ USHQIM

Materiali percjelles	Bakër. OFC
Diametri percjellesit	0.81±0.01mm
Diametri i izolatorit	3.66±0.05mm
Materiali i skermes	Alumin i veshur me baker. CCA
Materiali i izolatorit	PVC
Rezistenca	75ohms

22.1 Ushqimi

Materiali percjelles	Bakër. OFC
Sasia e percjellesave	2
Diametri i percjellesit	7*0.385±0.01mm
Materiali izolues	PE
Diametri izolatorit	1.8±0.1mm
Materiali izolatorit	PVC
Distanca transmetimit	Deri ne 200m
Temperatura e punes	-40 - +70°C

23. KABËLL ALARMI

Materiali percjelles	Bakër. OFC
Sasia e percjellesave	6
Diametri i percjellesit	2x05,4x022
Materiali izolatorit	PVC
Distanca transmetimit	Deri ne 150m
Temperatura e punes	-40 - +60°C

Për të mundësuar funksionimin me efikasitet të sistemeve Operatori ekonomik merr përsipër mundësimin e të gjithë infrastrukturës së nevojshme të ofrimit të shërbimit gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës/kontratave pjesë e marrëveshjes kuadër, sipas planifikimit orientues (por nuk kufizohet në) si më poshtë:

1	DVR 4 KANALE	90
2	DVR 8 KANALE	178
3	DVR 16 KANALE	124
4	DVR 32 KANALE	14
5	KAMERA TE BRENDSHME	1380
6	KAMERA TE JASHTME	1600
7	HDD 3 TB	180
8	HDD 4 TB	140
9	HDD 6 TB	100
10	USHQYES 12V 10 A	500
11	USHQYES 12V 5 A	480
12	MONITOR 22" CCTV	418
13	PLATFORME MENAXHIMI ALARMI, KAMERA, ZJARRI (SERVER)	1
14	KABINET METALIK	418
15	TRANSMETUES GPRS	418
16	MODUL MARRES 4 KANAL	418
17	BATER 12V 7 Ah	418
18	SENSOR LEVIZJE	2400
19	SENSOR ZJARRI	2800
20	SENSOR THYRJE WIRLESS	1600
21	PULT KOMANDIMI 2CH	418
22	SIRENE E JASHTME	418
23	KABËLL KAMERASH+ USHQIM	+/- 114360 m
24	KABËLL ALARMI	+/- 24000 m
25	MATERIALE, AKSESORË ETJ, TË NEVOJSHME PER INSTALIMIN SISTEMEVE (418 NJËSI SHËRBIMI/ GODINA)	

GRUPI I PUNËS